Spring 5-2021

EXPRESS.JS KUNDREJT NEST.JS: KRAHAISIMI I DY NODE.JS FRAMEWORK-AVE TË DEDIKUAR PËR SERVER

Blendi Misini

Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinierise

EXPRESS.JS KUNDREJT NEST.JS: KRAHAISIMI I DY NODE.JS FRAMEWORK-AVE TË DEDIKUAR PËR SERVER

Shkalla Bachelor

Blendi Misini

Maj / 2021
Prishtinë

Programi për Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinierise

Punim Diplome
Viti akademik 2017-2018

Blendi Misini

EXPRESS.JS KUNDREJT NEST.JS: KRAHAISIMI I DY NODE.JS FRAMEWORK-AVE TË DEDIKUAR PËR SERVER

Mentori: Msc. Lavdim Menxhiqi

Maj / 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij hulumtimi është krahasimi i dy framework të Node js përkatësisht NestJS dhe ExpressJS të cilat përdoren për ndërtimin e aplikacioneve efiqiente dhë të zgjerueshm e nga ana e serverit. Node.js e (njohur edhe si Node) është një përmbledhje e paketuar e motorit JavaScript V8 të Google, për ndërtimin e lehtë të aplikacioneve të shpejta,të shkallëzueshme dhe të lehta sa i përket hapsiërs memorike që këto framework alokojnë për nevojat e tyre. Node.js është një tekonologji e cila është ndërtuar duke u përqëndruar në performancën e lartë si dhe konsumin e ulët të memories kompjuterike. Në këtë punimë, ne ofrojmë një përmbledhje të dy Node.js framework-ave shumë të popullarizuar duke i krahasuar ata ndërmjet vete më qëllim që të kemi më të lehtë që të vendosim se cili prej tyre na përshtatet më shumë për nevojat tona të krijimit të një aplikacioni nga ana e serverit. Fillimisht, ne përqendrohemi në modularitetin e Node, disa nga vequritë e tij kryesore si dhe menyra e punës së tij, qfarë na ofronë më shumë në krahasimë me gjuhët e tjera që përdoren nga ana e serverit si dhe historikun e tij, gjithashtu lidhshmërinë e ngushtë me javascript dhe arkitekturën e punës së Node.js. Karakteristika kryesore e Node.js është përdorimi i non-blocking event-driven I/O me një model programimi asinkron për të mbetur i lehtë dhe efikas në trajtimin e shumë kërkesave njëkohsishtë e njohur ndryshe edhe si concurrency. Këto përmbajnë tiparet themelore të Node.js , të cilat i diskutojmë në detaje si dhe detajet e dy framework-ave të tij. Node.js ndryshon nga JavaScript të cilën ne e përshkruajmë duke theksuar disa mangësi të mëdha në JavaScript gjë që Node.js i rregullon këto mangësi. Po ashtu, duke krahasuar dy framework-at e Node.js do të shohim diferencat e tyre në implementimin e struktures së gatshme e cila na ofrohet out-of-the-box, si dhe sqarimin e qdo file të gjeneruar automatikisht nga këta framework-a, emertimin e tyre si dhe funksionalitetin të cilin na ofrojn e gjithashtu arsyjet e përdorimit të tij. Me Node.js, mund të ndërtohen aplikacione komplekse në kohë reale që mund të shkojnë deri në miliona lidhje klientësh njëkohsishtë. Ne gjithashtu diskutojmë faktorët që mbështesin zgjedhjen e Node.js dhe pse zhvilluesit duhet ta përdorin atë, si dhe benifitet e përdorimit të framework-ave të Node.js nga zhvilluesit e aplikacioneve nga ana e serverit por jo vetëm kaq, përdorimi i Node.js nga ana e serverit lehtëson edhe punen e zhvilluesve të aplikacionit nga ana e

klientit si dhe ul kostot e mirembajtjes dhe redukton numrin e kerkesave që duhet bërë për të punuar aplikacioni gjë që kemi trajtuar dhe permendur raste ku Node.Js ka permirsuar dhe optmizuar punën e aplikacioneve egzistues që kan kaluar pastaj ne Node.js. Do të diskutojmë dhe sqarojmë se si duhet të instalohen këto dy framework-a, dhe njëkohsishtë qfarë na ofrojnë ata nga instalimi bazik i tyre. Do të krijojmë një aplikacion bazikë ku do të shqyrtojmë se si duhët të krijohet i njejti aplikacion në dy framework-at. Gjithashtu, Node.js ofronë mundësin e lidhjes me databazë, ku suporton thuajse të gjitha llojet e databazave egzistuese. Do të ofrojmë nje shembull të lidhjes me databazë të të dy framework-ave me MongoDB një databazë e cila punonë shume mire me Node.js. Kur flasim për zgjerueshmërin e aplikacioneve komplekse dhe të mëdha, Node.js është një tekonologji e cila e ofron shumë mirë këtë shërbim, si në aplikacione më strukturë monolite edhe ato me microshërbime, do të diskutojmë gjithashtu se qfarë zgjerushmërie na ofrojnë këto dy frameworka të Node.js dhë cila është më e lehtë të zgjerohet, pasi që zgjerueshmëria e një aplikacioni është një ndër faktorët kryesorë të cilin duhet të kemi parasysh kur krijojmë një aplicakionë të madhë dhe kompleks. Node.js njihet gjithashtu për shpejtësin e saj shumë të madhe, pas krijimit të aplikacioneve tona të thjeshta ne do të bëjmë një krahasim ndërmjet tyre rreth performances si dhe qfarë mundësi na ofrojnë që të permirsojmë performancën e tyre. Përfundimi kryesor është që zhvilluesit duhet të kuptojnë se cili framework duhet të përdoret nga ta për nevojat dhe qëllimet e aplikacionit të tyre.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Fillimisht, falenderimi i takon Zotit për suksesin tim, ndaj të cilit përulem me krenari.
Punimi i temës së diplomës kërkon mund dhe përkushtim të madh i cili nuk mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, që më kanë mbështetur jo vetëm tani por gjatë gjithë rrugëtimit tim.
Falenderoj babain tim, Avni Misini dhe nënën time, Shefkije Misini të cilët besuan dhe më përkrahën në suksesin tim. Një falenderim i veçant shkon ndaj mentori tim të nderuar prof. Lavdim Menxhiqi i cili në mënyrë të vazhdushme më përcillte hap pas hapi drejt studimeve, ku me mbështetjen, dhe udhëzimet e vlefshme të profesorit synonim drejt ngritjes së nivelit të punimit.
Dhe krejt në fund, një falënderim shumë i sinqert i kushtohet shoqërisë për këshillat dhe përkrahjen e vazhdueshme, si dhe për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo çast.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE

1. HYRJE

Aplikacionet e bazuara në WEB janë duke rritur popullaritetin e tyre pasi po bëhen më të lehta për tu zhvilluar, mirëmbajtur dhe siguruar. Gjithashtu ato janë lehtësisht të arritshme për klientët dhe nuk kërkojnë instalime shtesë në shumicën e rasteve dhe janë të personalizueshme varësisht nga kërkesa e shfyrtëzuesit si dhe lehtë të menagjueshme. Gjithashtu rritja e popullaritetit të JavaScript ka sjellë me vete shumë ndryshime, dhe zhvillimi i web page sot ka ndryshuar në mënyrë dramatike nga më parë. Node.js lejon që JavaScript të përdoret në të dyja anët e web-page, si në server (back-end) ashtu edhe në ndërfaqen e klientit(front-end). Duke qenë JavaScript nga ana e serverit është një tjeter avantazh i admirueshëm i Node.js mbi të tjerat gjuhë programuese nga ana e serverit sepse nga një zhvillues do të kërkohet të ketë njohuri dhe përvojë vetëm të një gjuhe të vetme, dmth JavaScript, pa marrë parasysh nëse ai është zhvilluesi skripteve nga ana e klientit ose skriptet për anën e serverit. Zhvilluesit nuk i kërkohet të ndërrojë ciklet e trurit të tij për një gjuhë në anën e klientit dhe pastaj për një gjuhë tjetër në anën e serverit. Node.js gjithashtu ofron një bibliotekë të pasur me module të ndryshme JavaScript që thjeshton zhvillimin e aplikacioneve në internet duke përdorur Node.js në një masë të madhe. JavaScript fillimisht është ekzekutuar vetëm në shfletuesin e internetit, por kërkesa e konsiderueshme për të e ka sjellë edhe në anën e serverit gjithashtu. Gjërat që mund të bëjmë në internet ditët e sotme me JavaScript që ekzekutohet në server, si dhe në shfletues, ishin të vështira të imagjinoheshin vetëm disa vjet më parë, ose ishin të kapsuluara brenda ambienteve me sandbox si Flash ose Java Applelet.Wikipedia thotë se: "Node.js është një përmbledhje e paketuar e motorit JavaScript V8 të Google, shtresës së abstraksionit të platformës libuv dhe një bibliotekë thelbësore, e cila vetë shkruhet kryesisht në JavaScript." Node.js është një run-time mjedis që lejon zhvilluesit e programeve kompjuterikë të lancojnë front-end dhe back-end të aplikacioneve në internet duke përdorur JavaScript fillimisht i zhvilluar në 2009. Përtej kësaj, vlen të përmendet se Ryan Dahl, krijuesi i Node.js, po synonte të krijonte faqe të internetit që përpunonin dhe shfaqin të dhëna në kohë reale me aftësi shtytëse(push), "frymëzuar nga aplikacione si Gmail". Në Node.js, ai u dha zhvilluesve një mjet për të punuar në non-blocking, event-driven I/O paradigm. Pas mbi 20 vjet stateless-web pa `state` bazuar në paradigmën e kërkesës-përgjigje stateless, ne më në fund kemi aplikacione në internet me lidhje dy kahëshe në kohë reale. Në një fjali Node.js shkëlqen në aplikacione në kohë reale duke përdorur teknologji shtytëse mbi websockets. Çfarë është kaq revolucionare

në lidhje me këtë? Epo, pas mbi 20 vjet stateless-web bazuar në paradigmën e përgjigjjes së kërkesës stateless, ne më në fund kemi aplikacione në internet me lidhje në dy kohë, në kohë reale, ku klienti dhe serveri mund të fillojnë komunikimin, duke i lejuar ata të shkëmbejnë të dhëna lirisht . Kjo është në kontrast të plotë me paradigmën tipike të përgjigjjes në internet, ku klienti gjithmonë fillon komunikimin. Për më tepër, e gjitha bazohet në pirgun e hapur të uebit (HTML, CSS dhe JS) që kalon mbi portën standarde 80. Dikush mund të argumentojë se ne e kemi pasur këtë për vite në formën e Flash dhe Java Applets - por në të vërtetë, ato ishin thjesht ambiente me sandbox duke përdorur uebin si një protokoll transporti që do t'i dorëzohej klientit. Plus, ato drejtoheshin në izolim dhe shpesh operonin mbi porte jo standarde, të cilat mund të kenë kërkuar leje shtesë dhe të gjëra të tilla. Me të gjitha avantazhet e saj, Node.js tani luan një rol kritik në grumbullin teknologjik të shumë ndërmarrjeve të profilit të lartë që varen nga përfitimet e tij unike. Trafiku i përditshëm në internet po rrit kërkesën për të ofruar zgjidhje të reja për të përmirësuar natyrën e concurrent-te të shërbimit në applikacione [1]. Një zgjidhje të till e ofron Node.js (e cila nganjëherë quhet edhe Node ose nyja) e cila është e lehtë sa i përket hapsier memorike dhe plotëson kërkesat përmes modelit I / O të drejtuar nga eventet, dhe evente jo-bllokuese si dhe ofron JavaScript nga ana e serverit. Motori JavaScript V8 i Chrome është baza për Node.js pasi në të është ndërtuar koha e funksionimit JavaScript e Node.js [2]. V8 Google me performancë të lartë JavaScript dhe WebAssemble është motori me burim të hapur, i shkruar në C ++. Përdoret në Chrome dhe në Node.js. Zbaton ECMAScript dhe WebAssemble, dhe ekzekutohet në Windows 7 ose në versione më të reja të Windows, macOS 10.12+ dhe sisteme Linux që përdorin procesorë x64, IA-32, ARM ose MIPS. V8 mund të funksionojë i pavarur, ose mund të integrohet në çdo aplikacion C ++ [3]. Meqenëse Node.js është i bazuar në ngjarje dhe jo në thread-based, ai është gjithashtu i aftë për tu shkallëzuar në miliona lidhje njëkohësisht.

Figura 1:Disa nga framework më të popullarizuara të NodeJs [4].

2. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Framework-at për zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme përdoren për të organizuar progresin e zhvillimit të tyre. Zhvilluesit marrin strukturën e gatshme për bazën e tyre të kodit ku mund të aplikojnë elemente të ripërdorshëme si dhe të shpesh herë ofron shpejtësi më të madhe të aplikacionit. Përdorimi i framework-ave të uebit për pjesën e përparme është shumë më i zakonshëm. Përdorimi i framework-ave për backend është më pak i zakonshëm, por është shume i dobishëm. Kur punojmë në projekte të zhvillimit të uebit, për pjesen më të madhe të aplikacioneve përdorin framework-a për anën e klientit si dhe anën e serverit sepse është shumë efikase dhe e përshtatshëme pordorimi i framework-ave në të dyja anët.

Kur zgjedhim framework-in më të mirë të Node JS për projektet tona, gjithmonë i kushtojmë vëmendje faktorëve përcaktues. Normalisht, duhet përvojë për të zgjedhur framework-in e përshtatshm të Node.js për një detyrë ose aplikacion të veçantë, por ka disa rregulla që funksionojnë mirë për të determinuar se cilin framework të zgjedhim. Punimi ynë do të fokusohet në tri problemet kryesore qe duhët të kemi parasysh kur zgjedhim një Node Js framework, keto probleme lidhen ngushtë me këto pikat e mëposhtme hulumtuese:

- Çfarë arkitekture kanë këta dy framework-a?
- Si duhet ti instalojm?
- Si bëhet lidhja me databazë dhe sa lloje të databazave mbështesin?
- Sa janë të zgjerueshëm dhe të menagjueshëm?
- Si është performanca e përgjithshme e tyre?
- Sa ofronjnë funksionalitet?
- Sa e vështrië është të adaptohen zhvilluesit e rinjë me këta framework-a?

3. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Në këtë pjesë do të shqyrtojmë 2 framework të Node Js të cilët janë ExpressJS dhe NestJS per zhvillimin e aplikacioneve nga ana e serverit, ku do të shqyrtojm zgjerueshëmërin menagjueshëmërinë, performancat, si dhe funksionalitet të cilat naj ofrojnë këto dy framework-a të Node.js.

3.1 ExpressJS

Express.js u themelua nga TJ Holowaychuk. Lansimi i parë, sipas depozitës në GitHub të Express.js, ishte më 22 maj, 2010. Versioni 0.12.

Në qershor 2014, të drejtat për të menaxhuar projektin u morën nga StrongLoop. StrongLoop u ble nga IBM në shtator 2015; në janar 2016, IBM njoftoi se do të vendoste Express.js nën administrimin e inkubatorit të Fondacionit Node.js [5].

Express është framework më i popullarizuar në internet i Node.js dhe është biblioteka themelore për një numër framework-ave të tjerë të njohura të Node.js në internet. Ai siguron mekanizma për të:

- Shkruar handler për kërkesat me folje të ndryshme HTTP në shtigje (rrugë) të ndryshme URL.
- Integron me motorët e paraqitjes "view" në mënyrë që të gjeneroni përgjigje duke futur të dhëna në shabllone.
- Vendos rregullat e zakonshme të aplikacioneve në internet si porti për t'u përdorur për t'u lidhur dhe vendndodhja e modeleve që përdoren për dhënien e përgjigjes.
- Shtoni përpunimin e kërkesës shtesë "middleware" në çdo pikë brenda tubacionit të trajtimit të kërkesës [6].

3.2 NestJS

NestJS (i njohur si Nest) u zhvillua nga Kamil Myśliwiec me një mision për të ndërtuar aplikacione efektive, të shkallëzueshme me Node.js për backend. Ky framework mbështet gjuhën JavaScript dhe TypeScript. Për më tepër, ai përzien përbërësit e FP (Programim Funksional), OOP (Programim i Orientuar në Objekt) dhe FRP (Programim Reaktiv Funksional) [7].

Next.js u lanësua për herë të parë si një projekt me burim të hapur në GitHub më 25 tetor 2016. Ku është zhvilluar duke u bazuar në gjashtë parime kryesore: funksionalitet jashtë kutisë që nuk kërkon instalim, JavaScript kudo, të gjitha funksionet janë të shkruara në JavaScript, ndarje automatike të kodit dhe server-rendering, marrje të dhënash të konfigurueshme, parashikim i kërkesave dhe thjeshtsimi i deployment. Next.js 2.0 u prezantua në Mars 2017 duke përfshirë disa përmirësime që e bënë më të lehtë punën me faqe të vogla të internetit. Ai gjithashtu rriti efikasitetin e ndërtimit dhe përmirësoi shkallëzimin e tiparit të zëvendësimit të modulit të nxehtë. Versioni 7.0 u lëshua në shtator të vitit 2018 me përmirësimin e trajtimit të gabimeve dhe mbështetje për React's context API për përmirësimin e trajtimit dinamik të rrugës. Ky ishte gjithashtu versioni i parë në të cilin u azhurnua version më i ri i webpack. Versioni 8.0 u prezantua në Shkurt 2019 dhe ishte versioni i parë që ofroi vendosjen pa server të aplikacioneve, në të cilin kodi ndahet në funksione lambda që ekzekutohen sipas kërkesës. Versioni gjithashtu zvogëloi kohën dhe burimet e kërkuara për eksportet statike dhe përmirësoi performancën nga versioni paraprak Versioni 9.3, i prezantuar në Mars të 2020, përfshinte optimizime të ndryshme dhe mbështetje globale të modulit Sass dhe CSS. Më 27 korrik 2020, u botua versioni 9.5 i Next.js, duke shtuar aftësi të reja duke përfshirë rigjenerimin rritës statik, rishkrimet dhe mbështetjen e re-direct [8].

3.3 Arkitektura

Një arkitekturë aplikacioni ofron teknika dhe modele të hartuara mirë për të ndërtuar një aplikacion. Për më tepër, u siguron koduesve një udhërrëfyes dhe praktikat më të mira për të ndjekur dhe zhvilluar një aplikacion të strukturuar mirë . Për shembull, struktura e dosjeve dhe arkitektura e shtresave janë disa nga faktorët kryesorë që formojnë arkitekturën e përgjithshme të aplikacionit.

3.3.1 Arkitektura e ExpressJS

Express është një framework i Node.js per aplikacione në internet që ofron veçori të ndryshme përveç moduleve kryesore të Node.js që përshpejtojnë zhvillimin e uebit, si dhe e bëjnë më të lehtë zhvillimin. Express është një kombinim i middleware-ave që ekzekutohet nga lart poshtë në ciklin e kërkesës-përgjigjjes. Çdo middleware ka qasje në kërkesën dhe objektin e përgjigjjes.

Middleware merr kërkesën, ekzekuton kodin brenda, ndryshon kërkesën dhe objektet e përgjigjjes dhe thërret funksionin tjetër i cili aktivizon programin e middleware tjetër që

gjended në radhë. Një aplikacion i ExpressJS mund të ketë qasje në middleware të nivelit të aplikacionit, middleware të nivelit të routerit, middlware të trajtimit të gabimeve, middlware e integruar dhe middlware të palës së tretë. Middleware i nivelit të aplikacionit është i lidhur me një objekt të aplikacionit duke përdorur funksionet app.use () dhe app.method () ku 'method' është një folje HTTP që ekzekutohet. Middleware i nivelit te routerit ndryshon nga middleware i nivelit të aplikacionit vetëm pasi lidhet me një shembull të routerit ekspres. Middleware i trajtimit të gabimeve lidhet me objektin e aplikacionit dhe zakonisht kërkon katër argumente, gabimin, kërkesën, përgjigjjen dhe objektet e ardhshme. Middleware-at e integruara si express.static dhe express.json shërbejnë skedarët në mënyrë statike dhe analizojnë kërkesën hyrëse përkatësisht te JSON. Për më tepër, middleware e tjera të palëve të treta e zgjerojnë funksionalitetin e aplikacionit ExpressJS ose duke hyrë në informacionin në lidhje me kërkesën që është bërë ose duke analizuar cookies. Për më tepër, routerët në ExpressJS e ndajnë aplikacionin në disa aplikacione mini ExpressJS dhe i kombinojnë ato së bashku për të formuar një aplikacion të ExpressJS. Routeri i ExpressJS është i përbërë nga një folje e HTTP kërkese e cila mund të jetë (GET, POST, PUT, dhe DELETE) dhe një rrugë ose vendndodhen e burimeve të aplikacionit.

Për më tepër, callback funksionet specifikohen gjithashtu në metodën e rutimit ku një numër funksionesh callback mund të përdoren si argumente. Funksione të tilla callback duhet të thërrasin metodën tjetër të radhës nëse ka duke përdorur funksionin next() në mënyrë që të kalojnë në një tjetër callback funksion [9].

A



Figura 2:ExpressJS routing dhe http kerkesat.

3.3.2 Arkitektura e NestJS

Për sa i përket arkitekturës së NestJS, ekzistojnë 4 përparësi kryesore bazuar në artikujt dhe raportet ekzistuese. Së pari, NestJS është një framework i menduar mjaft mire. Një framework i menduar është një framework ku shtigjet e arkitekturës janë ndërtuar tashmë, dhe zhvilluesit duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna të strukturës pa bërë asnjë supozim (Skowronski 2019). Duke përcaktuar një arkitekturë të arsyeshme që çdo kodues duhet të zbatojë, ai ofron një koleksion standardesh, duke rezultuar në një bazë kodesh lehtësisht të mirëmbajtshme (Yadav 2020). Ai tashmë e mbyll kontrolluesin prapa skenave me një bllok try-catch, analizon kërkesën

trupi, shton një mbajtës gabimesh, middleware, regjistrues, etj. Prandaj, kur scaffolding një projekt të ri, zhvilluesit nuk kanë nevojë të bëjnë këto gjëra të zakonshme çdo herë. Për më tepër, ata duhet të shkruajnë depot, shërbimet, kontrollorët në një mënyrë të udhëzuar (Rahman 2019). Së dyti, aplikacionet e NestJS janë shkruar në Typescript. Me gjuhë të loosely typed si JavaScript ose PHP, kodi mund të shkruhet pa i munduar shumë zhvilluesit. Prandaj, rreziku për të pasur gabime është shume i madhë pa type script. Nga ana tjetër, Nest është ndoshta i vetmi sistem i strukturuar mirë që është shkruar plotësisht me Typescript. Typescript është një version typed i JavaScript që mbështet zhvilluesit gjatë kohës së përpilimit dhe kohës së ekzekutimit. Me pak fjalë, Typescript është një JavaScript i shkallëzueshëm. Typescript gjithashtu u ofron përdoruesve qasje në veçoritë e reja të JavaScript që nuk janë prezantuar

ende. Një nga qëllimet kryesore të NestJS është të ndërtojë aplikacione të shkallëzueshme, kështu që trashëgon të mirat e TypeScript. Së treti, NestJS ka një arkitekturë solide sikur se Angular. Shumica e framework-ave të JavaScript backend nuk përballen me arkitekturë. Në Nest, struktura e file-ave bazohet shumë në Angular. Si pasojë, kjo ofron downtime minimal kur krijojm një Nest service. Secili komponent merr follderin e tij, modulet dhe skedarët kryesorë që qëndrojnë në root (plus disa skedarë shtesë konfigurimi). Ky framework është aq themelore sa tingëllon dhe i bën zhvilluesit ti kushtojnë më shumë vëmendje hartimit të pikave fundore për klientët të tyre në vend të strukturës së aplikacionit [7].



Figura 3:Arkitektura e NestJS [7]

3.4 Instalimi

ExpressJS edhe NestJS instalohen përmes Node Package Manager. Kjo mund te bëhet duhke egzekutuar disa komanda për instalimin e tyre. Pra paraprakisht duhet të kemi të instaluar NodeJ, i cili mund të shkarkohet nga web page i NodeJs.

3.4.1 Instalimi i ExpressJS

ExpressJS mund ta instalojm shumë leht dhe shpejt përmes Node.js duke përdorur komanden **npm install express –save.**



Figura 4:Instalimi i ExpressJS përmes npm.

E njejta gjë mund të bëhet edhe nëpërmjet komandes **yarn add express** nëse e kemi paraprakishtë të instaluar **yarn**. Komandat e mësipërme kërkojnë që menaxheri i paketës së Node të shkarkojë modulet e kërkuara të ExpressJS dhe t'i instalojë ato në përputhje me rrethanat.



Figura 5:Përmbatja e një ExpressJS aplikacioni të sapo instaluar.

ExpressJS nuk ka nevojë për ndonjë komandë shtesë për krijimin e një aplikacioni. Le të përdorim faramework-un tonë Express të sapo instaluar dhe të krijojmë një aplikacion të thjeshtë "Hello World". Aplikacioni ynë do të krijojë një modul të thjeshtë serveri që do të dëgjojë numrin e portit 3000. Në shembullin tonë, nëse bëhet një kërkesë përmes shfletuesit në këtë numër porti, atëherë aplikacioni i serverit do të dërgojë një përgjigje 'Hello World ' tek klienti.

Për ta bërë këtë së pari duhet të krijojm një file të quajtur **index.js** në të njejtin follder që kemi instaluar ExpressJS. Pasi kemi krijuar file-in e emëruar me emrin **index.js** vendosim kodin si n figurën e mëposhtëme në atë file.

Figura 6:Kodi për krijimin e Hello World.

Tani dë të shpjegojmë kodin duke u bazuar në figurën më lart.

1. Në rreshtin tonë të parë të kodit, ne po përdorim funksionin **require** për të përfshirë "modulin e Express".
2. Para se të fillojmë të përdorim modulin e Express, duhet të krijojmë një objekt të tij.
3. Në rreshtin e tretë të kodit po krijojmë një funksion kthyes. Ky funksion do të thirret sa herë që dikush shfleton në rrënjën e aplikacionit tonë të internetit që është **http: // localhost: 3000**. Funksioni i kthimit do të përdoret për të dërguar vargun 'Hello World' në faqen e internetit
4. Në funksionin e kthimit, ne po i dërgojmë klientit vargun "Hello World". Parametri 'res' përdoret për të dërguar përmbajtje në faqen e internetit. Ky parametër 'res' është diçka që sigurohet nga moduli 'request' për të mundësuar që të dërgojë përmbajtje në faqen e internetit.
5. Atëherë ne jemi duke përdorur funksionin **app.listen** për të bërë që aplikacioni ynë server të dëgjojë kërkesat e klientit në portin nr 3000. Ju mund të specifikoni çdo port të disponueshëm këtu.

Pasi që kemi shtuar këtë kodë ne duhet që në të njejtin follder të egzekutojm komanden **node index.js** për të aktivizuar serverin tonë.



Figura 7:Komanda për egzekutimin e kodid të ExpressJS.

Për të parë rezultatin e kodit tonë, duhet të hapim shfletuesin dhe të nagivojm tek **http: // localhost: 3000.**

Figura 8:Rezultati i kodid në shfletues.

3.4.1 Instalimi i NestJS

Njejt sikur se ExpressJS, edhe NestJS instalohet përmes Node.js, vetëm se për instalimin e NestJS duhet të përdorim një komand tjetë e cila është **npm i -g @nestjs/cli**, dhe pastaj duhet të krijojmë një projekt me NestJS.



Figura 9:Instalimi i NestJS përmes npm.

Pas egzekutimit të suksesshëm të komandës më lart, navigojmë tek follderi ku dëshirojmë të ruajm projektin dhe pastaj ekzekutojm komandën **nest new nestjs-project**. Ndryshe nga Express Js, për të përdorur NestJS framework duhet të egzekutojm edhe këtë komand e cila krijon një aplikacion të zbrazët të NestJS.



Figura 10:Krijimi i NestJS aplikacionit përmes NodeJs.

Prap pas egzekutimit të suksesshëm të komandës më lartë, navigojm tek follderi nestjs-project pra tek aplikacioni të cilin e emertuam më lart, këtu do të shohim një strukturë më ndryshe në krahasim me ExpressJS.



Figura 11:File dhe follderat të cilat krijohen autoamtikisht me krijimin e një NestJS aplikacionit.

Folderi më i rëndësishm i projektit është follderi src. Ky është vendi ku do të gjeni file-at TypeScript në të cilin është kodi i aplikacionit brenda. Më vonë, kur zbatojmë shembullin tonë të parë të `Hello World` sikurse me ExpressJS, do ta kalojmë shumicën e kohës duke punuar

në këtë follder, ndryshe nga ExpressJS ku nuk kishim ndonjë strukturë paraprake, apo file-a të krijuara automatikisht [10].

Brenda dosjes src mund të gjeni pesë skedarë në konfigurimin fillestar të aplikacionit:

- main.ts: Pika hyrëse e aplikacionit. Duke përdorur metodën NestFactory.create () krijohet një instancë e re e aplikacionit Nest.
- app.module.ts: Përmban implementimin e modulit rrënjësor të aplikacionit.
- app.controller.ts: Përmban zbatimin e një kontrollori bazë NestJS me vetëm një rrugë.
- app.service.ts: Përmban zbatimin bazë të shërbimit.
- app.controller.spec.ts: Skedari i testimit për kontrolluesin.

Tani le ti hedhim një sy kodit të gjeneruar automatikisht. Në file-in main.ts. Do të gjeni zbatimin vijues të paracaktuar automatikisht:

```
import { NestFactory } from '@nestjs/core';
import { AppModule } from './app.module';

async function bootstrap() {
  const app = await NestFactory.create(AppModule);
  await app.listen(3000);
}
bootstrap();
```

Figura 12:Përmbajtja e main.ts file-it.

Kjo është pika e hyrjes së aplikacionit. Së pari, NestFactory importohet nga biblioteka @ nestjs / core. Për më tepër, AppModule importohet nga file app.module.ts i projektit tonë. Së dyti, funksioni bootstrap zbatohet dhe shënohet si async. Brenda këtij funksioni, thirret metoda NestFactory.create () dhe moduli i aplikacionit rrënjësor AppModule kalon në atë thirrje funksioni si argument. Kjo po krijon një shembull të ri të aplikacionit NestJS me modulin e bashkangjitur. Për të filluar serverin hapi tjetër është thirrja e metodës së dëgjimit dhe kalimi në portin në të cilin duhet të ekzekutohet serveri i internetit, p.sh. porti 3000 . Për shkak se metoda e dëgjimit po jep një promise kur serveri ka filluar me sukses, ne po përdorim fjalën await këtu. Më në fund skedari përmban thirrjen e funksionit bootstrap, në mënyrë që kodi të ekzekutohet.

Tjetra, le të hedhim një vështrim në zbatimin e modulit të kryesorë brenda aplikacionit që mund ta gjeni brenda file-it app.module.ts [10].

```
import { Module } from '@nestjs/common';
import { AppController } from './app.controller';
import { AppService } from './app.service';

@Module({
  imports: [],
  controllers: [AppController],
  providers: [AppService],
})
export class AppModule {}
```

Figura 13:Përmbajtja e app.module.ts file-it.

Për të deklaruar klasën AppModule si një modul përdoret dekoruesi @Module i cili importohet nga @ nestjs / biblioteka e përbashkët. Një objekt me tre veti kalohet në zbukuruesin @Module. Tre vetitë janë:

1. imports
2. controllers
3. providers

Të gjithë kontrolluesit që duhet të jenë pjesë e AppModule duhet të jenë pjesë e grupit i cili i është caktuar pronës së kontrolluesit (në gjendjen fillestare të aplikacionit ekziston vetëm një kontrollues i cili i është caktuar modulit root AppController). Shërbimet që duhet të jenë të disponueshme në AppModule duhet të renditen në grupin të cilit i është caktuar pronës së ofruesit [10].

Tjetra, le të shohim nga afër zbatimin e AppController në app.controller.ts.

```ts
import { Controller, Get } from '@nestjs/common';
import { AppService } from './app.service';

@Controller()
export class AppController {
  constructor(private readonly appService: AppService) {}

  @Get()
  getHello(): string {
    return this.appService.getHello();
  }
}
```

Figura 14: Përmbajtja e AppController.ts file-it.

Ky është një implementim shumë i thjeshtë i një kontrollori të NestJS i cili përbëhet nga vetëm një route GET. Për ta bërë një klasë një kontrollues, duhet të shtoni zbukuruesin @Controller. Ky zbukurues importohet nga biblioteka @ nestjs /common. Një kontrollues mbështetet në një klasë shërbimi. Në këtë shembull të paracaktuar, AppController përdor një shërbim të quajtur AppService. AppService po implementohet në file-in app.service.ts dhe për këtë arsye duhet të shtohet një deklaratë përkatëse e importit. Duke përdorur konceptin e Dependency Injection, AppService futet në AppController (duke shtuar një parametër konstruktor të atij lloji). Një rrugë e paracaktuar zbatohet duke zbatuar metodën getHello. Në mënyrë që të deklarohet që kjo metodë merret me një kërkesë HTTP GET, kësaj metode i shtohet edhe zbukuruesi @Get. Metoda është duke përdorur metodën getHello nga AppService për të marrë të dhëna dhe njëkohësisht për t'i kthyer ato të dhëna si përgjigje [10].

Le të vazhdojmë dhe të shohim se çfarë ka brenda app.service.ts.

```ts
import { Injectable } from '@nestjs/common';

@Injectable()
export class AppService {
  getHello(): string {
    return 'Hello World!';
  }
}
```

Figura 15:Përmbajtja e app.service.ts file-it.

Ky file përmban implementimin e klasës AppService. Për ta bërë AppService një klasë shërbimi (e cila mund të injektohet në një kontrollues siç është parë më lartë), dekoruesi @Injectable duhet të shtohet para kësaj klase. Përsëri, ky lloj dekoruesi importohet nga paketa @ nestjs / common. Zbatimi i klasës së shërbimit është shumë i thjeshtë dhe konsiston vetëm në zbatimin e metodës getHello. Kjo metodë thjesht po kthen vargun statik "Hello World!". Në një file të botës reale, një metodë shërbimi, natyrisht, do të përdorej për të marrë të dhëna p.sh. nga baza e të dhënave, një shërbim në internet, ose ndonjë burim tjetër i të dhënave. Tani, kjo është një përshtypje e parë e blloqeve më të rëndësishme të ndërtimit të aplikacionit të parazgjedhur NestJS, tani sikurse tek ExpressJS le ta startojm applikacionin dhe të shohim se qfar rezultati do të marrim nga shfletuesi.

Për të startuar aplikacionin tonë të NestJS duhet që, brenda follderit të NESTJS-PROJECT të cilin e krijuam më parë të gzekutojmë komandën **npm run start.**



Figura 16:Startimi i aplikacionit NestJS.

